



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 06.07.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

**MBI PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR
ZBATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KOMUNITETIT EVROPIAN, PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME
QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR”**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës shqyrtoi në mbledhjen e datës 06.07.2017 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relatore deputeti Xhemal Qefalia.

Qëllimi i marrëveshjes :

Ky projektligj ka për qëllim lehtësimin e zbatimit të marrëveshjes, ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, (nënshkruar më 14 prill 2005 dhe hyrë në fuqi më 1 maj 2006).

Përparësitë dhe efektet e pritshme të marrëveshjes:

Lufta kundër migrimit të paligjshëm dhe masat për parandalimin e tij përbëjnë një nga sfidat aktuale për vendet e BE-së dhe për vendet e rajonit. Kjo sfidë, konsolidimi dhe zgjerimi i Bashkimit Evropian, si dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadrin e procesit të stabilizim-asociimit e bëjnë të nevojshëm hartimin dhe nënshkrimin e një instrumenti ligjor, i cili ravijëzon frymën e partneritetit dhe vendos raporte të ndërsjella kontraktore detyruese ndërmjet një vendi anëtar të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për krijimin mbi bazë reciprociteti të procedurave të shpejta dhe efektive për identifikimin dhe ripranimin e personave, të cilët nuk plotësojnë ose nuk plotësojnë më tej kushtet për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Republikës së Shqipërisë ose

të njërës nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe të lehtësojë kthimin transit të këtyre personave në një frymë bashkëpunimi.

Përmbajtja :

Protokolli përbëhet nga 13 nene nga ku :

Neni 1 përcakton autoritetet kompetente të palëve dhe pikat e kontaktit të tyre.

Neni 2 përcakton pikat e kalimit kufitar në vendet respektive.

Neni 3 përcakton gjuhën angleze, si gjuhë komunikimi ndërmjet palëve, për zbatimin e këtij protokolli.

Neni 4 përcakton modalitetet e aplikimit për ripranim dhe të kthimit të përgjigjes për kërkesat për ripranim.

Neni 5 përcakton mjetet dhe dokumentet shtesë, nëse autoriteti kompetent i palës kërkuese konsideron se dokumente të tjera që nuk janë të renditura në shtojcat 1 dhe 4 të marrëveshjes janë të rëndësishme për të përcaktuar shtetësinë e personit që pritet të ripranohet apo për të përcaktuar arsyet për ripranimin e shtetasve nga vende të treta apo pa shtetësi. Dokumente të tilla mund t'i bashkëlidhen gjithashtu aplikimit të ripranimit që i dorëzohet autoritetit kompetent të palës së kërkuar.

Neni 6 përcakton autoritetet dhe modalitetet e kryerjes së intervistës të shtetasve, nëse nuk mund të paraqitet asnjë nga dokumentet e renditura në shtojcën 1 apo 2 të marrëveshjes.

Neni 7 përcakton dokumentacionin e nevojshëm për udhëtim kur jepet pëlqimi për ripranim.

Neni 8 përcakton mënyrën e njoftimit për transferimin, pasi është dhënë pëlqimi për ripranim që duhet të përmbajë të dhëna për datën dhe të dhënat e fluturimit për transferimin, si dhe mbi përdorimin e eskortës, në rast se do të përdoret.

Neni 9 përcakton modalitetet e aplikimit për kalimin transit.

Neni 10 përcakton se nëse ripranimi ose transiti kryhet me eskortë, oficerët e eskortës duhet të kryejnë detyrat e tyre të paarmatosur, të jenë të veshur civilë dhe të kenë me vete pasaportë të vlefshme dhe dokumente që konfirmojnë kushtet e ripranimit apo transitit.

Neni 11 parashikon se në operacionet e kthimit që ndërmerren nga pala kërkuese, për transferimet ose transitet që kryhen në zbatim të marrëveshjes, duhet të lejohen organet kombëtare dhe ndërkombëtare monitoruese të vëzhgojnë fazën e operacionit që kryhet në territorin e palës së kërkuar, duke përfshirë edhe dorëzimin e mundshëm të të kthyerve tek autoritetet e tyre, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 12 përcakton mënyrat e mbulimit të shpenzimeve nga palët, ku theksohet se shpenzimet mbulohen në euro nga pala kërkuese, siç është parashikuar në nenin 15, të marrëveshjes. Secila palë kontraktuese mbulon shpenzimet për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit për shtetasit e saj.

Neni 13 përcakton modalitetet për hyrjen në fuqi, përfundimin dhe amendimin e këtij protokolli.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare me shumicën e anëtarëve të pranishëm miraton projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi si dhe shprehet dakord për kalimin e këtij pr/ligji në seancë plenare.

Relator

Xhemal Qefalia

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ